---	---	--

<p>ajrit të parapara në Plani Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Planet afatshkurta të veprimit</p> <p>1.Nëse në një zonë ose aglomerat të caktuar ekziston rreziku nga tejkalimi i pragut të alarmit të ndotjes, Komuna për atë zonë ose aglomerat harton Planin Afatshkurt të Veprimit, i cili përmban masat që duhet të ndërmerren në afat të shkurtër, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut dhe ose uljes së ndotjes.</p> <p>2.Plani Afatshkurt i Veprimit nga paragrafi 1. i këtij neni, varësisht nga rastet individuale, mund të parasheh masat efektive të kontrollit dhe ku është e nevojshme, të ndaloj veprimtaritë të cilat shkaktojnë rrezik të tejkalimit të vlerave kufitare, vlerave të synuara ose pragut të alarmit.</p> <p>3.Plani Afatshkurt i Veprimit mund të përfshijë masa lidhur me: qarkullimin e mjeteve motorike, veprimtaritë ndërtimore, punën e stabilimenteve industriale, përdorimin e prodhimeve industriale, ngrohjen në amvisëri dhe ti parasheh edhe veprimtaritë specifike, me qëllim të mbrojtjes së grupeve të ndjeshme të popullatës.</p> <p>4.Nëse në zonën apo aglomeratin e caktuar ekziston rreziku nga tejkalimi i pragut të alarmit</p>	<p>provided by the Local Action Plan for Air Quality.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Short-term action plans</p> <p>1. If in a given zone or agglomeration there is a risk of exceeding the alarm threshold, Municipality for that zone or agglomerate designs a Short-term Action Plan, which includes measures to be taken in the short term, with the aim of reducing the risk and reduce air pollution.</p> <p>2.The Short-term Action Plan from paragraph 1 of this article, depending on individual cases, may provide effective control measures and where appropriate, prohibit activities that risk to cause the risk of exceeding the limit values, target values or alert thresholds.</p> <p>3.The Short-term Action Plan may include measures relating to: the movement of motor vehicles, construction activities, the performance of industrial installations, and the use of industrial products, heating in households and specific foresee activities, with the aim of protecting vulnerable groups of the population.</p> <p>4. If in a zone or agglomeration there is a risk to exceed the alarm threshold for surface ozone,</p>	<p>vazduha predvidene Lokalnim Akcionim Planom za Kvalitet Vazduha.</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Kratkoročni Akcioni Planovi</p> <p>1.Ako u jednoj određenoj zoni ili aglomeraciji postoji opasnost od prekoračenja praga upozorenja zagađenja, Opština za tu zonu ili aglomeraciju donosi Kratkoročni Akcioni Plan, koji sadrži mere koje se moraju poduzeti u kratkom roku, s ciljem smanjenja opasnost ili smanjenja zagađenja.</p> <p>2. Kratkoročni Akcioni Plan iz stavke 1. ovog člana, zavisno od individualnih slučajeva, može predvideti efektivne mere kontrole i gde je to potrebno, da zaustavi delatnosti koje prouzrokuju opasnost prekoračenja graničnih vrednosti, ciljanih vrednosti ili praga upozorenja.</p> <p>3. Kratkoročni Akcioni Plan može obuhvatati mere vezane za: promet motornih vozila, građevinske radove, rad industrijskih postrojenja, upotrebu industrijskih proizvoda, grejanje u domaćinstvima i predvideti i specifične aktivnosti sa ciljem zaštite osetljivih grupa stanovništva.</p> <p>4. Ako u određenoj zoni ili aglomeraciji postoji opasnost od prekoračenja praga upozorenja za</p>
---	---	--

<p>për ozonin sipërfaqësor, Ministria përgatitë Planin Afatshkurt të Veprimit vetëm për atë pjesë ku sipas vlerësimit ekziston potenciali i konsiderueshëm për zvogëlimin e rrezikut ose vazhdimin të gjendjes së njëjtë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike, meteorologjike dhe ekonomike.</p> <p>5.Ministria dhe Komuna informojnë publikun, përfshirë palët e interesuara për rezultatet e kërkimeve të bëra, realizimin dhe përmbajtjen e planit afatshkurtër të veprimit, si dhe zbatimin e këtij plani.</p> <p>6.Ndotësi është i obliguar ti zbatoj dhe financoj masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, të përcaktuara në Planin Afatshkurt të Veprimit nga paragrafi 1. i këtij neni.</p>	<p>the Ministry shall prepare a Short-term Action Plan only in areas where it exists considerable potential for reducing the risk or the continuation of the same situation taking into account geographical, meteorological and economic conditions.</p> <p>5. The Ministry and the Municipality inform the public including stakeholders on the results of research conducted, realisation and content of the short-term action plan and implementation of this plan.</p> <p>6.The polluter is obliged to implement and fund the measures for reducing the air pollution, specified in the Short term Action Plan from paragraph 1 of this article.</p>	<p>prizemni ozon, Ministarstvo priprema Kratkoročni Akcioni Plan samo tamo gde prema proceni postoji značajan potencial za smanjenje opasnosti ili održavanje istog stanja vodeći računa o geografskim, meteorološkim i ekonomskim uslovima.</p> <p>5. Ministarstvo i Opština obaveštavaju javnost uključujući zainteresovane stranke za rezultate izvršenih istraživanja, izvodljivosti i sadržaju Kratkoročnog Akcionog Plana, kao i primenu ovog plana.</p> <p>6. Zagađivač je obavezan provesti i financirati mere za smanjenje zagađenja vazduha, predviđenih u Kratkoročnom Akcionom Planom iz stavke 1. ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 30 Raporti për realizimin e Planeve të Veprimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 30 Report on the implementation of the Action Plans</p>	<p style="text-align: center;">Član 30 Izveštaj o realizaciji Akcionih Planova</p>
<p>1.Me qëllim të monitorimit të arritjes së objektivave të Strategjisë dhe Planeve të përmendura në nenin 27, 28 dhe 29 të këtij ligji dhe dokumenteve tjera relevante për mbrojtjen e ajrit, shtresës së ozonit si dhe pasqyrës së gjendjes së cilësisë së ajrit dhe harxhimin e substancave që e hollojnë shtresën e ozonit për Republikën e Kosovës, përgatitet Raporti i realizimit të planit, për një periudhë katër (4) vjeçare.</p>	<p>1.For the purposes of monitoring the achievement of the objectives of the Strategy and Plan mentioned in article 27, 28 and 29 of this Law and other relevant documents for the protection of air, ozone layer and overview as well as the state of air quality, and consumption of substances that deplete the ozone layer, a Report on the implementation of the plan is prepared for the Republic of Kosovo for a period of four (4) years.</p>	<p>1.Za praćenje dostizanja ciljeva Strategije i Planova pomenutih u članu 27, 28 i 29 ovog Zakona i ostalih relevantnih dokumenata za zaštitu vazduha, ozonskog sloja kao i pregleda stanja kvaliteta vazduha i potrošnje supstanci koje osiromašuju ozonski sloj za Republiku Kosova priprema se Izveštaj o realizaciji plana za razdoblje od četiri (4) godine.</p>

<p>2.Institucionet të cilat janë bartëse të planeve nga neni 27, 28 dhe 29 duhet të përgatisin Raportin për realizimin e planit, i cili përmban:</p> <p>2.1.gjendjen e cilësisë së ajrit: informatat për territorin/ niveli i ndotjes, qëndrueshmëria e niveleve të caktuara të ndotjes, llojet dhe vlerësimet e ndotjes, prejardhjen e ndotjes, analizën e faktorëve të cilët kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, të dhënat për masat e ndërmarra dhe projektet për përmirësimin e cilësisë së ajrit;</p> <p>2.2.vlerësimin e masave të realizuara dhe ndikimet e tyre;</p> <p>2.3. realizimin e masave të planit, programit dhe dokumenteve të tjera për mbrojtjen cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit;</p> <p>2.4. zbatimin e obligimeve ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së ajrit dhe shtresës së ozonit;</p> <p>2.5. të dhënat për ndëshkimet e shqiptuara;</p> <p>2.6. të dhënat për shfrytëzimin e mjeteve financiare për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;</p>	<p>2.The institutions that are the carriers of the plans under article 27, 28 and 29, must prepare Report on the implementation of the plan, which includes:</p> <p>2.1. the state of the air quality: information on the territory, the level of pollution, the sustainability of the certain levels of pollution, pollution type and assessments, origin of pollution, analysing of factors that has contributed to the air pollution, data on measures taken and projects for the improvement of air quality;</p> <p>2.2.assessment of measures implemented and their impact;</p> <p>2.3.implementation of the measures of plan, program and other documents for air quality and ozone layer protection;</p> <p>2.4.implementation of international obligations from the field of air and ozone layer protection;</p> <p>2.5.data on imposed penalties;</p> <p>2.6.data on the use of funds for protection and improvement of air quality;</p>	<p>2.Institucije koji su nosioci planova iz člana 27, 28. i 29 treba da pripreme Izveštaj o realizaciji plana, koji sadrži:</p> <p>2.1.stanje kvaliteta vazduha: informacije o teritoriji/ nivo zagađenja, postojanost određenih nivoa zagađenja, vrste i procene zagađenja, poreklo zagađenja, analizu faktora koji su uticali na zagađenje vazduha, podatci i preduzete mere i projekti za poboljšanje kvaliteta vazduha;</p> <p>2.2.procenu sprovedenih mera i njihov uticaj;</p> <p>2.3.realizaciju mera plana, programa i ostalih dokumenata za zaštitu kvaliteta vazduha i ozonskog sloja;</p> <p>2.4.sprovođenje međunarodnih obaveza iz oblasti zaštite vazduha i ozonskog sloja;</p> <p>2.5. podatke o izrečenim kaznama;</p> <p>2.6. podaci o korišćenju finansijskih sredstava za zaštitu i poboljšavanje kvaliteta vazduha;</p>
---	---	---

<p>2.7.propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve ekzistuese si dhe të dhënave të tjera me rëndësi për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit;</p> <p>3.AMMK është bartëse e përgatitjes së raportit për zbatimin e dokumenteve nga neni 27 dhe 29 të këtij ligji, të cilin Ministria ia dërgon Qeverisë për miratim.</p> <p>4.Komuna është bartëse e përgatitjes së raportit për zbatimin e planit nga neni 28, të cilin ia dërgon Ministrisë.</p>	<p>2.7.proposal for change and amendment of existing documents and other important data for air quality and ozone layer.</p> <p>3.KEPA is the carrier for preparation of the report for implementation of the documents from article 27 and 29 of this Law, shall be submitted by the Ministry to the Government for approval.</p> <p>4.The municipality is bearer of the preparation of the report on the implementation of the plan from article 28, which will be submitted to the Ministry.</p>	<p>2.7. predloge za izmene i dopune postojećih dokumenata kao i ostalih važnih podataka za zaštitu kvaliteta vazduha i ozonskog sloja;</p> <p>3. AZOK je nosilac izrade izveštaja o primeni dokumenata iz člana 27. i 29. ovog Zakona, koji izveštaj Ministarstvo dostavlja Vladi za usvajanje.</p> <p>4. Opština ja nosilac izrade izveštaja o primeni plana iz člana 28, koju šalje u Ministarstvo.</p>
<p>Neni 31 Informimi i publikut për Planet e Veprimit</p>	<p>Article 31 Informing of the public about the Action Plans</p>	<p>Član 31 Obaveštavanje javnosti o Akcionim Planovima</p>
<p>1.Ministria, draftin final të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit nga neni 27 dhe planit nga neni 29 të këtij Ligji, raportin nga neni 30 paragrafi 3 i këtij ligji si dhe Komuna, draftin final të planit të veprimit nga neni 28 dhe 29 të këtij Ligji dhe raportin nga neni 30 paragrafi 4 të këtij ligji, duhet ti publikojnë në ueb faqet e tyre për marrjen e mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve eventuale.</p> <p>2. Ministria respektivisht Komuna informon publikun përmes mediave për vendin në të cilin dokumentet nga paragrafi 1 të këtij neni janë</p>	<p>1.The Ministry the final draft of the Strategy and Action Plan for air quality from article 27 and 29 of this Law, the report from article 30 paragraph 3 of this Law and the Municipality the final draft of the action plan from article 28 and 29 of this Law and the report from article 30 paragraph 4 of this Law, shall publish on their web sites for obtaining opinions, remarks and eventual suggestions.</p> <p>2.Ministry, respectively Municipality informs the public through the media about the location in which the documents from paragraph 1 of this</p>	<p>1.Ministarstvo konačni nacrt Strategije i Akcionog Plan iz člana 27. i 29. ovog Zakona, izveštaj iz člana 30. stavka 3. ovog Zakona, kao i Opština konačni nacrt Akcionog Plan iz člana 28. i 29. ovog Zakona i izveštaj iz člana 30. stavka 4. ovog Zakona treba da objave na svojim veb sajtovima za uzimanje mišljenja, primedbi i eventualnih predloga.</p> <p>2. Ministarstvo odnosno Opština obaveštava javnost preko media za mesto u kojem dokumenti iz stavke 1. ovog člana su objavljeni</p>

<p>publikuar si dhe për mënyrën dhe kohën e dhënies së mendimeve, vërejtjeve dhe sygjërimeve.</p> <p>3.Afati për dhënien e mendimeve, vërejtjeve dhe sygjërimeve nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë, nga dita e publikimit.</p> <p>4.Ministria respektivisht Komuna për dokumentet nga paragrafi 1 i këtij neni i shqyrtojnë mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna dhe vlerësojnë arsyeshmërinë e tyre.</p> <p>5.Pas miratimit të dokumenteve nga paragrafi 1 i këtij neni, ato do të publikohet në "Gazetën Zyrtare " të Republikës së Kosovës.</p>	<p>article are published and the manner and timing of giving opinions, comments and suggestions.</p> <p>3.The deadline for providing of opinions, comments and suggestions cannot be shorter than thirty (30) days from the date of publication.</p> <p>4.Ministry, respectively Municipality shall consider the opinions, comments and suggestions for documents from paragraph 1 of this article and assess their reasonableness.</p> <p>5. After the adoption of the documents referred to in paragraph 1 of this article, they shall be published in the "Official Gazette" of the Republic of Kosovo.</p>	<p>kao i o načinu i vremenu davanja mišljenja, primedbi i predloga.</p> <p>3.Rok za davanje mišljenja, primedbi i predloga ne može biti kraći od trideset (30) dana od dana objavljivanja.</p> <p>4. Ministarstvo odnosno Opština za dokumente iz stavke 1. ovog člana razmatraju data mišljenja, primedbe i predloge i procenjuje njihovu opravdanost.</p> <p>5. Nakon usvajanja dokumenata iz stavke 1. ovog člana, one se objavljuju u "Službene Novine" Republike Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Plani Kombëtar i Zvogëlimin të Emetimeve</p> <p>1. Në periudhën prej 1 janarit 2018 deri më 31 dhjetor 2027, për impiantet e palëvizshme për djegie, tek të cilat të hyrat e përgjithshme nominale termike janë 50 MË ose më shumë dhe për të cilat leja e parë për operim është lëshuar para datës 27 nëntor 2002 ose për të cilën një aplikim i plotë për autorizimin e parë të operimit, është dorëzuar para kësaj date dhe të cilat janë vënë në veprim më së voni deri më 27 nëntor 2003, operatori nuk është i detyruar të përmbushë VKE specifike, për oksidet e azotit,</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 National Emission Reduction Plan</p> <p>1. In the period from 1 January 2018 till 31 December 2027, for stationary combustion plants whose total rated thermal input is 50 MW or more and for which the first operating permit was issued before 27 November 2002 or for which a full application for first authorization of operation was submitted before that date, and which were put into operation by 27 November 2003 at the latest, the operator is not obliged to meet the specific ELV for nitrogen oxides, solid pollutants and sulfur</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Nacionalni Plan za Smanjenje Emisija</p> <p>1. U periodu od 1. januara 2018. do 31. decembra 2027. Godine za stacionarne postrojenja za sagorevanje čija ukupna nominalna toplotna snaga je 50 MW ili više, i za koju je prva dozvola izdata pre 27. novembra 2002. godine ili za koju je puna prijava za prvo odobrenje operacije je dostavljen pre tog datuma, a koji su pusteni u rad najkasnije do 27. novembra 2003. godine, operator nije obavezan da ispuni specifične GVE za okside azota, čvrste zagađivače i sumpor-dioksida, utvrđene</p>

<p>ndotësit e ngurtë dhe dioksidin e squfurit të cilat përcaktohen me aktin nënligjor sipas Nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, nëse këto burime të palëvizshme përfshihen në Planin Kombëtar të Zvogëlimin e Emisioneve sipas paragrafit 5 të këtij neni.</p> <p>2. Operatori i një impianti të palëvizshëm për djegie të madhe, në Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve, duhet të plotëson vlerat kufitare të shkarkimeve, të përcaktuara në lejen e punës për operim/ njoftimin në fuqi më 31 dhjetor 2017 dhe tavanet e emetimeve për çdo vit të specifikuar në Planin Kombëtar të Zvogëlimit të Emisioneve. Këto kufijtë e emetimeve janë vendosur në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga Komuniteti i Energjisë në bazë të kontributit të përgjithshëm aktual të vlerësuar, të impianteve të palëvizshme për djegie të madhe të 31 dhjetorit 2012, orëve aktuale të përdorimit vjetor dhe karburantit të përdorur në vlerat mesatare gjatë 5 viteve të operimit deri në fund, duke përfshirë 2012.</p> <p>3. Nëse taveri i vendosur është më i lartë se taveri i emetimit, i llogaritur për impiantin e palëvizshëm për djegie të madhe, në përputhje me lejen operative të vlefshme deri më 31 dhjetor 2017, operatori është i detyruar të përmbushë kufirin e emetimit sipas lejes së punës më 31 dhjetor, 2017. Operatori i dy ose më shumë impiantëve të palëvizshëm për djegie të madhe, në vend të përmbushjes së</p>	<p>dioxide laid down in the sub-legal act referred to in Article 6 paragrph 2 of this Law, if these stationary combustion sources are included in the National Emission Reduction Plan pursuant to paragraph 5 of this Article.</p> <p>2. The operator of a stationary combustion plant, included in the National Emission Reduction Plan should complies with meets the emission limit values set out in the operating permit for operation/ notification in force on 31 December 2017 and the emission ceilings for each year specified in the National Emission Reduction Plan. These emission ceilings are set in accordance with the methodology developed by the Energy Community on the basis of the total actual rated thermal input of combustion stationary sources at 31 December 2012, their actual annual operating hours and fuel used in the average values during the last 5 years of operation up to and including 2012.</p> <p>3. If the emission ceiling so established is higher than the emission ceiling calculated for the stationary combustion plant in accordance with the valid operating permit as of 31 December 2017, the operator is obliged to meet the emission ceiling according to operating permit on December 31, 2017. The operator of two or more of stationary combustion plants instead of meeting the emission ceilings</p>	<p>podzakonskim aktom iz u članu 6 stavka. 2 ovog zakona, ako su ti stalni izvori sagorevanja uključeni u Nacionalni Plan za Smanjenja Emisije u skladu sa stavom 5 ovog člana.</p> <p>2. Operator stacionarnog postrojenja za sagorevanje, uključen u Nacionalni Planu za Smanjenja Emisija, mora biti u skladu sa graničnim vrijednostima emisije utvrđenim u operativnoj dozvoli za rad / obavještanje na snazi 31. decembra 2017. godine, a gornje granice emisije za svaki godinu određena u Nacionalnom planu smanjenja emisije. Ove granice emisije utvrđuju se u skladu sa metodologijom koju je razvila Energetska zajednica na osnovu ukupnog stvarnog nominalnog utroška toplotne energije stacionarnih izvora sagorevanja na dan 31. decembra 2012. godine, njihovog stvarnog godišnjeg radnog vremena i goriva korištenih u prosječnim vrijednostima tokom posljednjih 5 godine rada, uključujući 2012. godinu.</p> <p>3. Ako je plafon veći od plafona emisije, izračunat za stacionarna postrojenja za sagorevanje, u skladu sa operativnom dozvolom koja važi do 31. decembra 2017. godine, operator je dužan da ispunji limit emisija prema radnoj dozvoli 31. decembra 2017. Operator dve ili više stacionarnih postrojenja za sagorevanje, umesto ispunjavanja plafona emisije utvrđenih</p>
---	---	---

<p>tavaneve të emisioneve të vendosura për impiant individual për djegie të madhe, plotëson tavanet e emisioneve të cilat janë shuma e tavaneve të emisioneve të vendosura për këto burime të palëvizshme të djegies. Operatorët e dy ose më shumë impianteve të palëvizshme për djegie sipas fjalisë së pare, mund të shkëmbejnë pjesë të tavaneve të emisioneve ndërmjet tyre, përveç nëse shuma e tavaneve të emetimit të këtyre burimeve të palëvizshme të djegies rritet në krahasim me statusin e para-shkëmbimit ose këta impiant janë lënë jashtë Planit Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve.</p>	<p>established for individual stationary combustion plant, fulfils the emission ceilings which are the sum of the emission ceilings established for these stationary combustion sources. Operators of two or more stationary combustion plants under the first sentence may exchange parts of the emission ceilings between them, unless the sum of the emission ceilings of these combustion stationary resources is increased compared to the pre-exchange status or these plants are omitted from National Emission Reduction Plan.</p>	<p>za pojedine stacionarne postrojenja za sagorevanje, ispunjava gornje granice emisije koje su zbir graničnih vrijednosti emisije utvrđene za ove stalne izvore sagorevanja. Operateri dve ili više stacionarnih postrojenja za sagorijevanje prema prvoj rečenici mogu razmjenjivati dijelove graničnih vrijednosti emisije između njih, osim ako se povećava zbir graničnih vrijednosti emisije ovih stalnih izvora sagorevanja u poređenju sa statusom pre razmjene ili ako su te biljke izostavljene Nacionalni Plan za Smanjenja Emisija.</p>
<p>4. Regjimi i tranzicionit, të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nuk zbatohet për emisionet e oksideve të azotit për burimet e impiantëve të palëvizëshëm për djegie me hyrje të përgjithshme termike të vlerësuar, më të madhe se 500 MË, që djegin lëndë djegëse të ngurtë për të cilat është lëshuar leja e parë për operim në ose pas 1 Korrikut 1987. data e oksideve. Në rastin e turbinave me gaz, regjimi i tranzicionit i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, zbatohet vetëm për emisionet e oksideve të azotit.</p>	<p>4. The transitional regime referred to in paragraph 1 of this Article shall not apply to the emissions of nitrogen oxides to stationary combustion plants sources with a total rated thermal input greater than 500 MW firing solid fuels for which the first permit for operation was issued on or after 1 July 1987. oxides date. In the case of gas turbines, the transitional regime referred to in paragraph 1 shall apply only to the emissions of nitrogen oxides.</p>	<p>4. Prelazni režim iz stava 1. ovog člana neće se primjenjivati na emisije azotnih oksida u stacionarne izvore sagorevanja sa ukupnom ulazom toplote većim od 500 MW koji pune čvrsta goriva za koje je izdata prva dozvola za rad ili posle 1. jula 1987. godine. U slučaju gasnih turbina, prelazni režim naveden u stavu 1 ovog člana, primenjuje se samo na emisije azotnih oksida.</p>
<p>5. Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve do të përfshijë një listë të burimeve të palëvizshme për djegie, për të cilat nuk kërkohet të përmbushin vlerat kufitare të shkarkimeve të emisioneve specifike, të përcaktuara me aktin nënligjor të përmendur në</p>	<p>5. The National Emission Reduction Plan shall include a list of stationary combustion sources included which are not required to meet the specific emission limit values set out in the sub-legal act referred to Article 6.paragraph 2 of this law for one or more of the pollutants</p>	<p>5. Nacionalni Plan za Smanjenje Emisija obuhvata listu nepokretnih izvora sagorevanja koji nisu potrebni da zadovolje specifične granične vrijednosti emisija utvrđene podzakonskim aktom iz člana 6. stav 2. ovog zakona za jedan ili više zagađujuće materije</p>

<p>nenin 6 paragrafi .2 të këtij ligji, për një ose më shumë ndotës të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe duhet të specifikojë për të gjithë ndotësit tek të cilët zbatohen tavanet e emisioneve për secilin burim të palëvizshëm të djegies, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, masat e planifikuara për të siguruar përmbushjen e vlerave kufitare të emisioneve specifike të përcaktuara në aktin nënligjor të përmendur më lartë, jo më vonë se 31 Dhjetor 2027 dhe mënyrën e monitorimit dhe raportimit të përmbushjes së tij.</p>	<p>defined in paragraph 1 of this Article and shall specify for all the pollutants to which it applies, emission ceilings for each stationary combustion source pursuant to paragraph 2 of this Article, measures planned to ensure the fulfilment of the specific emission limits set out in the above mentioned sub-legal act no later than 31 December 2027, the method of monitoring and reporting on its fulfilment.</p>	<p>definisane u stavu 1. ovog člana i navesti za sve zagađujuće materije za koje se primjenjuje, gornje granice emisije za svaki stacionarni izvor sagorevanja u skladu sa stavom 2 tv kvrtij neni, mjere planirane kako bi se osigurala ispunjavanje specifičnih granica emisije utvrđenih u gore pomenuti podzakonski akt najkasnije do 31. decembra 2027. godine, način praćenja i izveštavanja o njegovom ispunjavanju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 33 Ndotja ndërkuftare e ajrit</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Trans-boundary air pollution</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Prekogranično zagađenje vazduha</p>
<p>1.Nëse për shkak të bartjes së konsiderueshme ndërkuftare të ndotësve të ajrit ose prekursorëve të tyre, tejkalohen; pragu i paralajmërimit, vlerat kufitare, vlerat e synuara, kufiri i tolerancës ose objektivi afatgjatë, Ministria bashkëpunon me organet kompetente të shteteve fqinje dhe mund të iu propozoj përgatitjen e planeve të përbashkëta të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit në përputhje me nenin 29 të këtij Ligji, me qëllim të shmangies së tejkalimeve të tilla, duke zbatuar masa përkatesë si dhe masa proporcionale.</p>	<p>1.If due to significant cross-border transmission of air pollutants or their precursors the warning threshold, the limit values, target values, limits of tolerance or long-term objectives are exceeded, the Ministry cooperates with the competent authorities of neighbouring countries, and may propose to prepare joint action plans to improve the air quality in accordance with article 29 of this Law, in order to avoid such exceedance by implementing appropriate measures and proportionate measures.</p>	<p>1.Ako se zbog znatnog međugraničnog prenosa zagađivača vazduha ili njihovih prekursora prekoračuje prag obaveštenja, granična vrednost, ciljana vrednost, granica tolerancije ili dugoročni cilj, Ministarstvo saraduje sa nadležnim telima susednih država i može da im predloži pripremu zajedničkih akcionih planova za poboljšavanje kvaliteta vazduha u skladu sa članom 29. ovog Zakona, sa ciljem izbegavanja takvih prekoračenja primenjujući određene mere kao i proporcionalne mere.</p>
<p>2.Ministria, në bashkëpunim me organet kompetente të shteteve fqinje sipas nevojës, në pajtim me nenin 29 të këtij Ligji, përgatitë dhe zbaton masat e përbashkëta afat shkurta të planit</p>	<p>2.The Ministry, in cooperation with the competent authorities of neighbouring countries as needed, in accordance with article 29 of this Law, shall prepare and implement joint</p>	<p>2.Ministarstvo, u saradnji sa nadležnim telima susednih država prema potrebi, u skladu sa članom 29. ovog Zakona, priprema i primenjuje zajedničke kratkoročne mere akcionog plana</p>

<p>të veprimit të cilat përfshijnë territoret e vendeve fqinje duke siguruar shkëmbimin e të gjitha të dhënave të nevojshme dhe relevante.</p> <p>3.Nëse është tejkaluar pragu i rrezikut në zonat ose aglomeratet të cilat janë në afërsi të kufijve shtetëror, të dhënat i dërgohen në mënyrë më të shpejtë të mundshme organeve kompetente të shteteve fqinje. Në këto të dhëna ka qasje edhe publiku.</p> <p>KAPITULLI VII AKREDITIMI</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Akreditimi</p> <p>1.Për kryerjen e aktiviteteve për monitorimin e cilësisë së ajrit, aktiviteteve të monitorimit të emisioneve të materieve ndotëse në ajër, nga burimet e palëvizshme dhe aktiviteteve të verifikimit të saktësisë së pajisjeve matëse për matje të vazhdueshme të emisioneve të ndotësve në ajër nga burimet palëvizshme, personi juridik respektivisht laboratorit testues dhe kalibruet duhet të i përmbush kushtet e parapara në Nenin 12 paragrafi 3 të këtij Ligji.</p> <p>2.Certifikatën për akreditim nga paragrafi 1 i këtij neni, e lëshon AKA.</p>	<p>measures of short-term action plan which include the territories of neighbouring countries providing exchange of all necessary and relevant data.</p> <p>3.If the alert threshold is exceeded in zones or agglomerations which are close to state borders, the data shall be submitted in the fastest way possible to the competent authorities of neighbouring countries. The public shall have access to this data.</p> <p>CHAPTER VII ACCREDITATION</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Accreditation</p> <p>1.To carry out the activities for monitoring of the air quality, the activities of monitoring the emissions of pollutants into the air from stationary sources and activities to verify the accuracy of measuring devices for measuring continuous emissions of pollutants in the air from stationary sources, the legal person respectively the testing and calibration laboratory must fulfil the condition foreseen in article 12, paragraph 3 of this Law.</p> <p>2.Certificate for accreditation from paragraph 1 of this Article is issued by KAA.</p>	<p>koje obuhvaćaju teritorije susednih država obezbeđujući razmenu svih potrebnih i relevantnih podataka.</p> <p>3.Ako je prekoraćen prag opasnosti u zonama ili aglomeratima koje su u blizini državnih granica, podatci se dostavljaju na najbrži mogući način nadležnim telima susednih država. Ovi podatci su dostupni za javnost.</p> <p>POGLAVLJE VII AKREDITACIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Akreditacija</p> <p>1.Za obavljanje aktivnosti za praćenje kvaliteta vazduha, aktivnosti praćenja emisija zagađujućih materija na vazduhu iz nepokretnih izvora i aktivnosti verifikacije ispravnosti opreme za merenje za kontinualno merenje emisija zagađujućih materija na vazduhu iz nepokretnih izvora, pravna osoba odnosno laboratorija za testiranje i kalibraciju treba da ispunjava uslove predviđene u članu 12. stavka 3. ovog Zakona.</p> <p>2.Certifikat (Uverenje) o akreditaciji iz stavke 1. ovog člana izdaje AKA.</p>
---	---	---

<p>3.Personi juridik- laborator hulumtues pas akreditimit, brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të njoftoi Ministrinë me shkrim, të cilës shkresë ia bashkëngjit:</p> <p>3.1.Certifikatën e akreditimit (origjinali ose kopja e vërtetuar) sipas kërkesës së standardit EN ISO/IEC 17025 ose metodave të tjera të standardizuara, të pranuar ndërkombëtarisht, me aneksin e akreditimit për cilësinë e ajrit si dhe për sigurimin e cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit, sipas metodave dhe standardeve të përcaktuara në legjislacionin për cilësinë e ajrit, si dhe me përshkrimin e metodave referente të matjeve ose metodave tjera matëse, për të cilat është kryer procedura e vërtetimit të ekuivalencës me metoda referente të matjeve, të përcaktuara në aktin nënligjor nga neni 12 paragrafi 1 të këtij ligji;</p> <p>3.2.Certifikatën e akreditimit (origjinali ose kopja e vërtetuar) sipas kërkesës së standardit EN ISO/IEC 17025 ose metodave të tjera të standardizuara, të pranuar ndërkombëtarisht, me aneksin e akreditimit për monitorimin e emisioneve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme, me përshkrim të metodave referente të matjeve ose metodave tjera matëse për të cilat është kryer procedura e vërtetimit të ekuivalencës me metoda</p>	<p>3.The legal person-testing and calibration laboratory after the accreditation within 30 days should inform the Ministry in written with the following documents attached:</p> <p>3.1.Accreditation certificate (original or certified copy) as per requirement of the standard EN ISO/ IEC 17025 or other standardized methods, internationally recognized with the annex of accreditation for air quality and quality assurance of measurements and data on air quality according to the methods and standards set in legislation on air quality, as well as the description of the reference measurement methods or other methods of measurement for which an equivalent authentication procedure is performed with the reference measurement methods specified by the sub legal act from article 12 paragraph 1 of this Law;</p> <p>3.2.Accreditation certificate (original or certified copy) as per requirement of the standard EN ISO/ IEC 17025 or other standardized methods, internationally recognized with the annex of accreditation for monitoring of emissions of pollutants in the air from stationary sources with a description of the reference measurement methods or other methods of measurement for which an equivalent authentication procedure is performed with the reference</p>	<p>3.Pravna osoba-laboratorija za istraživanje nakon akreditacije u roku od trideset (30) dana treba obavestiti Ministarstvo pismeno, i dopisu u prilogu dostaviti:</p> <p>3.1.Certifikat akreditacije (original ili uverenu kopiju) po zahtevu standarda EN ISO/IEC 17025 ili drugih standardizovanih metoda, međunarodno priznate sa aneksom o akreditaciji za kvalitet vazduha i osiguravanja kvaliteta merenja i podacima za kvalitet vazduha po metodama i standardima uređenim u zakonskim aktima o kvalitetu vazduha, kao i opis referentnih metoda merenja ili drugih metoda merenja za koje je završena procedura potvrđivanja ekvivalentnosti sa referentnim metodama merenja određenim podzakonskim aktom iz člana 12. stavke 1. ovog Zakona;</p> <p>3.2.Certifikat akreditacije (original ili uverenu kopiju) po zahtevu standarda EN ISO/IEC 17025 ili drugih standardizovanih metoda, međunarodno priznate sa aneksom o akreditaciji za praćenje emisija zagađivača u vazduhu iz nepokretnih izvora, sa opisom referentnih metoda merenja ili ostalih metoda merenja za koje je izvršena procedura potvrđivanja ekvivalentnosti sa referentnim metodama merenja određenim</p>
---	---	---

<p>referente të matjeve, të përcaktuara me aktin nënligjor nga neni 6 paragrafi 2, të këtij ligji;</p> <p>3.3. Certifikatën e akreditimit (origjinali ose kopja e vërtetuar) sipas kërkesës së standardit EN ISO/IEC 17025 ose normave të tjera të standardizuara, të pranuar ndërkombëtarisht me aneksin e akreditimit, për monitorimin kontinual të emisioneve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme, me përkrahje të metodave referente të matjeve të emisioneve të cilat janë në harmoni me standardi EN 14181 ose metodave të tjera të standardizuara, të pranuar ndërkombëtarisht.</p> <p>4.Vërtetimin e laboratorit referent për sigurimin e cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit me metoda të caktuara të matjeve në paragrafin 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të këtij neni e lëshon laboratorit referent i autorizuar nga Ministria, nga neni 38 të këtij ligji.</p> <p>5.Pavarësisht nga paragrafi 4 të këtij neni, nëse në Republikën e Kosovës për një metodë të caktuar referente të matjes nuk ekziston laboratorit referent, pranohet origjinali ose kopja e vërtetuar e vërtetimit të laboratorit referent për sigurimin e cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit për metoda të caktuara të matjeve, të ndonjë shteti anëtarë të Bashkimit</p>	<p>measurement methods specified by the sub-legal act referred to article 6, paragraph 2 of this Law.</p> <p>3.3. Accreditation certificate (original or certified copy) as per requirement of the standard EN ISO/IEC 17025 or other equivalent standardized norms, internationally recognized with the annex of accreditation for continuous monitoring of emissions of pollutants in the air from stationary sources with a description of the reference emissions measurement methods which are in line with the EN 14181 standard or other standardized methods, internationally recognized.</p> <p>4.Certificate from the reference laboratory for quality assurance of measurements and data on air quality with methods of measurements specified in paragraph 3 sub.paragraph 3.1 and 3.2.of this article is issued by the reference laboratory authorized by Ministry, from article 38 of this Law.</p> <p>5.Notwithstanding paragraph 4. of this article, if in the Republic of Kosovo there is not a reference laboratory for a certain method of measurement, the original or a certified copy of a certificate of reference laboratory for measurement quality assurance and the data on air quality for certain methods of measurement by any member state of the European Union will</p>	<p>podzakonskim aktom iz člana 6. stavke 2. ovog Zakona;</p> <p>3.3. Certifikat akreditiranja (original ili uverenu kopiju) po zahtevu standarda EN ISO/IEC 17025 ili drugih standardizovanih normi, međunarodno priznate sa aneksom o akreditaciji za kontinualno praćenje emisija zagađivača u vazduhu iz nepokretnih izvora, sa opisom referentnih metoda merenja emisija koje su u saglasnosti sa standardom EN 14181 ili drugih ekvivalentnih standardizovanih metoda, međunarodno priznatih.</p> <p>4.Potvrdu referentnog laboratorija za osiguravanje kvaliteta merenja i podataka o kvalitetu vazduha sa utvrđenim metodama merenja u stavci 3., podstavci 3.1. i 3.2. ovog člana izdaje ovlašćena referentna laboratorija od strane Ministarstvo, iz člana 38. ovog Zakona.</p> <p>5. Ne uzimajući u obzir stavku 4. ovog člana, ako u Republici Kosovo za neku određenu referentnu metodu ne postoji referentna laboratorija, priznaje se original ili overena kopija potvrde referentne laboratorije za osiguravanje kvaliteta merenja i podataka o kvalitetu vazduha za određene metode merenja neke države članice Evropske Zajednice.</p>
--	--	---

<p>European. Vërtetimi duhet të jetë i përkthyer në gjuhën zyrtare nga ana e përkthyesit të autorizuar.</p> <p>6.Laboratori referent nga neni 38 të këtij ligji lëshon Vërtetimin, që për metodat tjera të matjes së cilësisë së ajrit janë kryer testet e ekuivalencës sipas metodave dhe standardeve të përcaktuara në legjislacionin për cilësinë e ajrit të cilat janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.</p> <p>7.Shkresës nga paragrafi 3 i këtij neni personi juridik- laboratorit testues dhe kalibruet ia bashkëngjit edhe vërtetimet nga paragrafi 4, 5, 6 të këtij neni.</p> <p>8. Pas tetëmbëdhjetë (18) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, personi juridik- laboratorit testues dhe kalibruet nuk mund të kryen matjet e cilësisë së ajrit dhe emisioneve nga burimet e palëvizshme të ndotjes, pa qenë i akredituar.</p>	<p>be accepted. Certification must be translated into the official language by an authorized translator.</p> <p>6.The referent laboratory from article 38 shall issue a certificate that for other measurement methods of air quality,where the equivalency tests are carried out according to methods and standards set out in legislation on air quality which are consistent with the standards of the European Union.</p> <p>7.The legal person-testing and calibration laboratory shall attach to the letter from paragraph 3 of this Article the certificates from paragraph 4, 5, 6 of this article.</p> <p>8. After eighteen (18) months from the date of entry into force of this Law, the legal entity - the testing and calibration laboratory can not perform the measurements of air quality and emissions from stationary sources of pollution without being accredited.</p>	<p>Potvrda mora da je prevedena u službeni jezik od strane ovlašćenog prevodioca.</p> <p>6. Referentna laboratorija iz člana 38. ovog Zakona izdaje Potvrdu da su za ostale metode merenja kvaliteta vazduha izvršeni testovi ekvivalentnosti po metodama i standardima utvrđenim zakonodavstvom za kvalitet vazduha koja su u skladu sa usaglašenim standardima Evropske Zajednice.</p> <p>7. Dopisu iz stava 3. ovog člana pravna osoba- laboratorija za testiranje i kalibraciju dostavlja i potvrde iz stavke 4., 5. i 6. ovog člana.</p> <p>8. Nakon osamnaest (18) meseci od dana stupanja na snagu ovog zakona, pravno lice- laboratorija za ispitivanja i kalibraciju ne može izvesti merenja kvaliteta vazduha i emisija iz stacionarnih izvora zagađenja, ako nije akreditovan.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Vetmonitorimi</p> <p>Pronari ose shfrytëzuesi i burimit të ndotjes së ajrit mund të kryej në mënyrë të pavarur monitorimin e cilësisë së ajrit dhe monitorimin e emisioneve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme, brenda veprimtarisë së tij të</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Self-monitoring</p> <p>The owner or user of the source of air pollution can perform independent monitoring of the air quality and monitoring of emissions of pollutants into the air from stationary sources, within the operations of his registered activity, if</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Samonadzor</p> <p>Vlasnik ili korisnik izvora zagađenja vazduha može izvršiti nezavisno praćenje kvaliteta vazduha i praćenje zagađujućih emisija na vazduhu iz nepokretnih izvora, unutar njegove registrovane delatnosti, ako je akreditiran</p>

<p>regjistruar, nëse është i akredituar komfor nenit 12 paragrafi 3 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Vlefshmëria e akreditimit</p> <p>1. Akreditimi nga neni 34 paragrafi 1 dhe neni 38 të këtij Ligji, është i vlefshëm 4 vite dhe mirëmbajtja e akreditimit do të kontrollohet nga AKA, për çdo vit.</p> <p>2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, leja për ushtrimin e veprimtarisë së monitorimit të cilësisë së ajrit e lëshuar në bazë të vërtetimit të laboratorit referent nga neni 12 paragrafi 3 të këtij ligji lëshohet për periudhën pesë vjeçare me kusht që për çdo vit të vlefshmërisë së akreditimit, personi juridik- laboratorit testues dhe kalibruet duhet ti sjell Ministrisë vërtetimin e ri të laboratorit referent.</p> <p>3. Nëse personi juridik- laboratorit testues dhe kalibruet i cili është akredituar nga paragrafi 2 i këtij neni nuk ia sjell vërtetimin nga laboratorit referent Ministrisë për ndonjë vit të vlefshmërisë së akreditimit, të njëjtit i merret vërtetimi i akreditimit nga ana e AKA-s.</p> <p>4. Në rast të ndryshimit dhe plotësimit të kushteve për lëshimin e vërtetimit për akreditim nga neni 35 dhe 39 të këtij Ligji, personi juridik</p>	<p>it is accredited in conformity with article 12, paragraph 3 this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Validity of accreditation</p> <p>1. Accreditation from article 34, paragraph 1 and article 38 of this Law, is valid for 4 years and the maintenance of accreditation will be controlled by KAA, every year.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this article, the permit to perform the activities of monitoring of the air quality is issued based on the certificate from the reference laboratory from article 12, paragraph 3 of this Law and shall be issued for a period of five years provided that for each year of accreditation validity the legal person - testing and calibration laboratory should bring to the Ministry the new certification from the reference laboratory.</p> <p>3. If the legal person- testing and calibration laboratory which is accredited by paragraph 2 of this article does not bring to the Ministry a certificate from the referent laboratory for any year of the validity of the accreditation, the same certificate of accreditation will be taken by KAA.</p> <p>4. In case of changing or amending the conditions for issuance of the certificate for accreditation from article 35 and 39 of this Law,</p>	<p>saglasno sa članom 12., stavkom 3. ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Važnost akreditacije</p> <p>1. Akreditacija iz člana 34. stavka 1. i člana 38. ovog Zakona, je punovažan 4 godine i održavanje akreditacije proverava se od AKA, svake godine.</p> <p>2. Ne uzimajući u obzir stav 1. ovog člana, dozvola za vršenje delatnosti praćenja kvaliteta vazduha izdata na osnovu potvrde referentne laboratorije iz člana 12, stavka 3. ovog Zakona izdaje se za razdoblje od pet godina sa uslovom da za svaku godinu važnosti akreditacije pravna osoba-laboratorija za testiranje i kalibraciju treba da dostavi Ministarstvu novu potvrdu referentne laboratorije.</p> <p>3. Ako pravna osoba-laboratorija za testiranje i kalibriranje koja je akreditovana iz stavke 2. ovog člana ne dostavlja potvrdu iz referentne laboratorije Ministarstvu za neku godinu važnosti akreditacije, istom se oduzima potvrda akreditacije od strane AKA.</p> <p>4. U slučaju izmena i dopuna uslova za izdavanje potvrde o akreditaciji iz člana 35. i 39. ovog Zakona, pravna osoba je obavezna da u</p>
--	---	--

<p>është i obliguar ta njoftoj Ministrinë në afat prej tet (8) ditëve nga dita e ndryshimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Vërtetësia dhe saktësia e të dhënave</p> <p>1. Personi juridik i cili është akredituar nga AKA, ka për detyrë që punët e monitorimit të cilësisë së ajrit, emisioneve në ajër dhe kontrollin vjetor të pajisjeve të sistemit matës për matje kontinuale të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme ti kryej me cilësi dhe përgjegjësi, në pajtim me rregullat e profesionit, si dhe është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë profesionale të të dhënave dhe punëve të kryera.</p> <p>2. Personi juridik i akredituar duhet të siguroj paanshmërinë e punëtorëve të tij dhe të cilët nuk duhet të jenë të ekspozuar ndaj presioneve të biznesit, financiare dhe të tjera, të cilat mund të ndikojnë në gjykimin e tyre teknik.</p>	<p>the legal person is obligated to notify the Ministry within eight (8) days from the day of the change.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Authenticity and accuracy of data</p> <p>1. Legal person who is accredited by the KAA is obliged to perform the monitoring of air quality, air emissions and the annual control of measurement system equipments for continuous measurements of emission of pollutants from stationary sources, with quality and responsibility, in accordance with rules of the profession as well responsible for the professional accuracy and authenticity of data and works.</p> <p>2. Legal person who is accredited should ensure the impartiality of its employees, who should not be exposed to pressures of business, financial and other pressure, which could affect their technical judgment.</p>	<p>roku od osam (8) dana od dana izmena, za to obavesti Ministarstvo.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Verodostojnost i tačnost podataka</p> <p>1. Pravna osoba koja je akreditirana od strane AKA, dužna je da poslove praćenja kvaliteta vazduha, emisija na vazduhu i godišnju kontrolu uređaja mernog sistema za kontinualno merenje zagađujućih emisija iz nepokretnih izvora vršiti kvalitetno i odgovorno, u skladu sa profesionalnim pravilima, kao i odgovorna je za profesionalnu verodostojnost i tačnost podataka i izvršenih radova.</p> <p>2. Akreditirana pravna osoba treba da obezbedi nepristrasnost radnika i koji ne trebaju biti izloženi pritiscima poduzetništva, finansijskim i ostalim, koji mogu uticati na njihovu tehničku presudu.</p>
